

VENDIM
Nr. 813, datë 28.12.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 531, DATË 7.9.2023, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE
SHTETËRORE “OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA” SHA, PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE TË VEÇANTA TË PROKURIMIT PUBLIK, NË
EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“20. Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP) do të vijojë të kryejë procedurat e veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë deri në fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së Organit të Blerjeve të Përqendruara sh.a. (OBP).”

b) Në pikën 21, fjalja e parë riformulohet, si më poshtë vijon:

“Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. njofton me shkrim institucionet e përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, për datën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, datë e cila përcaktohet me urdhër të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.”

c) Në pikën 23, fjalët “Me mbylljen e ushtrimit të veprimtarisë së ASHPP-së, sipas këtij vendimi ...” zëvendësohen me “Me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së OBP sh.a. ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia e Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama